

KOMISIONI RREGULATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION

2024

ANALIZË

MODULI I MENAXHIMIT TË KONTRATËS

PERIUDHA 2021 - QERSHOR 2024

ANALIZË

MODULI I MENAXHIMIT TË KONTRATËS

Periudha 2021 - Qershor 2024

Përmbajtja

1. Hyrje dhe Kontekst Ligjor	4
3. Qëllimi i Modulit	4
4. Analiza e Përdorimit të Modulit	5
5. Trendi i Përdorimit Vjetor	6
Rekomandime	17

1. Hyrje dhe Kontekst Ligjor

Bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, dhe Rregulloren 01/2022 për Prokurim Publik, KAPITULLI V rregullon Menaxhimin e Kontratës dhe Vlerësimin e performancës së kontraktuesve, sipas të cilit, ZKA në Autoritetet Kontraktuese pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, do ta emërojë një Menaxher të Kontratës përgjegjës për menaxhimin e kontratës specifike dhe një mbikqyrës të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës. Ky proces i menaxhimit të kontratës është thelbësor për të siguruar zbatimin efektiv dhe efikas të kontratave publike, duke kontribuar në transparencën dhe llogaridhënien e procesit të prokurimit publik.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në vitin 2021 ka lansuar në platformën e-prokurimi modulën për Menaxhimin e Kontratave nga Autoritetet Kontraktuese. Si i tillë, ky modul është një mekanizëm shtesë i llogaridhënies, që mundëson menaxhimin më transparent dhe efikas të kontratave publike. Të dhënat tregojnë se që nga viti 2021, ka pasur një rritje të përdorimit të këtij moduli nga ana e Autoriteteve Kontraktuese.

3. Qëllimi i Modulit

Moduli i Menaxhimit të Kontratës synon të adresojë sfidat e mëparshme në menaxhimin manual të kontratave, duke ofruar një platformë të centralizuar për monitorimin dhe raportimin e progresit të kontratave. Kjo platformë lehtëson koordinimin mes palëve të përfshira, përmirëson gjurmueshmërinë e vendimeve dhe veprimeve, si dhe mundëson një pasqyrë më të qartë të statusit të kontratave në kohë reale.

Menaxhimi i Kontratës bëhet vetëm për kontratat me vlerë të vogël, vlerë të mesme dhe vlerë të madhe, ndërsa vlerësimi i performancës së kontraktuesve bëhet vetëm për kontratat me vlerë të mesme dhe vlerë të madhe. Plan i Menaxhimit të Kontratës (PMK) përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të menaxherit të kontratës nga ana e AK dhe menaxherit të kontratës nga ana e Operatorit Ekonomik. Pas aprovimit dhe nënshkrimit të Planit për Menaxhim të Kontratës (PMK), i njëjti plan do të jetë në dispozicion për shkarkim nga ana e departamentit të prokurimit.

Në këtë raport, janë të paraqitura të dhënat statistikore të nivelit të përdorimit të Modulit të Menaxhimit të Kontratës, ndër vite, përmes sistemit e-prokurimi.


Për analizë janë marrë për bazë të dhënat referuar periudhës Janar – Dhjetor 2021, 2022 & 2023 deri në muajin Qershor 2024, të cilat rezultojnë si më poshtë.

**Për sqarim, menaxhimi i kontratës bëhet vetëm për kontratat me vlerë të vogël, vlerë të mesme dhe vlerë të madhe, pra nga kjo analizë janë të përjashtuara kontratat me vlerë minimale dhe konkurset e projektimit për të gjitha vitet.*

4. Analiza e Përdorimit të Modulit

Në total janë nënshkruar **22,993** kontrata, nga të cilat **14,409** prej tyre kanë Status të Planit të Menaxhimit të Kontratës, ky plan është aprovuar nga të dyja palët, aprovuar nga Autoriteti Kontaktues apo Aprovuar nga Operatori Ekonomik sipas të dhënave të sistemit figuron për **13,011** kontrata, kurse **1,398** kanë statusin në realizim, apo refuzur nga AK dhe OE.

Shprehur në përqindje nga **22,993** kontrata të dhëna, Plan të Menaxhimit të Kontratës kanë **13,011** prej tyre, pra në total: **56.60 %**. Kjo përqindje tregon një adoptim të konsiderueshëm të modulit, megjithatë sugjeron gjithashtu që ka ende hapësirë për përmirësim në përdorimin e tij. Faktorët që mund të ndikojnë në këtë shkallë adoptimi përfshijnë nivelin e trajnimit të stafit, infrastrukturën teknologjike të disponueshme, dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e përdorimit të modulit përmes platformës.







Totali i kontratave të dhëna dhe plani i menaxhimit të kontratës

5. Trendi i Përdorimit Vjetor¹

- Gjatë vitit 2021 nga 5,884 kontrata të nënshkruara, 3,140 prej tyre kishin statusin e PMK të aprovuar nga të dyja palët, të aprovuar nga AK apo të aprovuar nga OE, apo në përqindje **53.40%**.
- Gjatë vitit 2022, nga 6,836 kontrata të nënshkruara, 3,872 prej tyre kishin statusin e PMK të aprovuar nga të dyja palët, të aprovuar nga AK apo të aprovuar nga OE, apo në përqindje **56.64 %**.
- Gjatë vitit 2023, nga 7,309 kontrata të nënshkruara, 4,441 kishin statusin e PMK të aprovuar nga të dyja palët, të aprovuar nga AK apo të aprovuar nga OE, apo në përqindje **60.80%**.
- Gjatë periudhës Janar-Qershor 2024, nga 2,923 kontrata të nënshkruara, 1,547 prej tyre kishin statusin e PMK të aprovuar nga të dyja palët, të aprovuar nga AK apo të aprovuar nga OE, apo në përqindje **52.92%**.

Trendi rritës i përdorimit të modulit nga viti 2021 deri në 2023 tregon një adoptim gradual dhe të qëndrueshëm të sistemit. Kjo rritje mund t'i atribuohet disa faktorëve, përfshirë përmirësimin e ndërgjegjësimit për modulin, trajnimet e vazhdueshme të ofruara, dhe potencialisht përmirësime në vetë platformën. Rënia e lehtë e vërejtur në periudhën Janar-Qershor 2024 mund të jetë për shkak të natyrës sezonale të prokurimit publik dhe pamundësisë së krahasimeve meqenëse kemi të bëjmë vetëm me 6 mujorëshin e parë të vitit, trend ky që pritet të ndryshojë deri në fund të vitit.

¹Me termin kontrata të nënshkruara, në këtë analizë i referohen totalit të kontratave me vlerë ulët, vlerë të mesme dhe vlerë të madhe, duke mos përfshirë në llogaritje numrin total të kontratave me vlerë minimale dhe konkurset e projektimit, të cilat sipas Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik nuk janë të obliguara të bëjnë menaxhimin e kontratës përmes sistemit elektronik.



Totali i kontratave dhe planet e menaxhimit te kontratave

- Grafiku tregon një rritje të qëndrueshme si në totalin e kontratave, ashtu edhe në ato me plan menaxhimi nga 2021 deri në 2023.
- Përqindja e kontratave me plan menaxhimi është rritur nga 53.40% në 2021 në 60.80% në 2023, duke treguar një adoptim në rritje.
- Rënia e lehtë në 52.92% në gjysmën e parë të 2024 mund të jetë për shkak të faktorëve sezonalë ose të dhënave jo të plota.





Në grafën e parë në aksin lartë është paraqitur numri total i kontratave të nënshkruara dhe kontratat të cilat kanë Status të Planit të Menaxhimit të Kontratës përmes sistemit eprokurimi, për vitet 2021- Qershor 2024. Kurse, në grafën në anën e djathtë lartë, ky raport është shprehur në përqindje, nga të cilat rezulton që në vitin 2021, 53.4% ka qenë niveli i përdorimit të Modulit të Menaxhimit të Kontratës.

Në vitin 2022, kjo përqindje ka shënuar rritje duke rezultuar kështu me 56.64% dhe në vitin 2023 gjithsej 60.80% ka qenë niveli i përdorimit të Modulit të Menaxhimit të Kontratës. Për vitin 2024 nuk mund të bëjmë konkludime ende sepse të dhënat përfshihen vetëm deri në muajin Qershor 2024.

Në grafën poshtë, anën e majtë janë paraqitur numri i kontratave sipas statusit të tyre ndër vite nëse të njejtat janë: *në realizim, janë përfunduar apo janë ndërprerë.*

Kurse, në anën e djathtë është paraqitur raporti i shprehur në përqindje nga të cilat rezulton që në vitin 2021, 82.9% e kontratave kanë qenë në realizim, 15.5% janë përfunduar dhe 1.6% janë ndërprerë.

Në vitin 2022, 84.5% e kontratave kanë qenë në realizim, 14.2% janë përfunduar dhe 1.3% janë ndërprerë. Kurse në vitin 2023, 91.1% e kontratave kanë qenë në realizim, 9.3% janë përfunduar dhe 0.6% janë ndërprerë.



Përdorimi sipas llojit të kontratës, vlerës, procedurës dhe nivelit qeveritar

- Lloji i kontratës: Kontratat për furnizime vazhdojnë të përbëjnë pjesën më të madhe (43-45%), të ndjekura nga shërbimet dhe punët;
- Vlera e kontratës: Kontratat me vlerë të mesme dominojnë (53-54%), me një rritje të dukshme në kontratat me vlerë të lartë nga 14.8% në 2021 në 18.9% në 2023;
- Lloji i Procedurës: Procedurat e hapura janë më të zakonshme, duke u rritur nga 59.9% në 2021 në 67.3% në 2023 dhe përdorimi i modulit nga niveli qendror është vazhdimisht më i lartë (54-59%) se sa ai lokal.



Në grafën e parë lartë, janë paraqitur përqindja e përdorimit të Modullit të Menaxhimit të Kontratës sipas llojit të kontratës ndër vite. Nga këto të dhëna rezulton që në vitin 2021, 43.8% e kontratave të menaxhuara përmes sistemit kanë qenë për furnizim, 32% shërbime dhe 24.2% punë. Në vitin 2022, 45.8% e kontratave të menaxhuara përmes sistemit kanë qenë për furnizim, 26.9% shërbime dhe 27.3% punë. Në vitin 2023, 43.4% e kontratave të menaxhuara përmes sistemit kanë qenë për furnizim, 28.1% shërbime dhe 28.6% punë.

Në grafën e dytë, lartë ana e djathtë, është paraqitur niveli i përdorimit të Modullit Menaxhimi i Kontratës sipas vlerës së kontratës, nga të cilat rezulton që në vitin 2021, 14.8% e kontratave të menaxhuara përmes sistemit ishin me vlerë të madhe, 53.9% me vlerë të mesme dhe 31.3% me vlerë të vogël. Në vitin 2022, 15.4% e kontratave të menaxhuara përmes sistemit ishin me vlerë të madhe, 53.1% me vlerë të mesme dhe 31.4% me vlerë të vogël. Në vitin 2023, 18.9% e kontratave të menaxhuara përmes sistemit ishin 18.9% me vlerë të madhe, 54.6% me vlerë të mesme dhe 26.5% me vlerë të vogël.

Në grafën poshtë, ana e majtë, është paraqitur niveli i përdorimit të Planit të Menaxhimit të Kontratës sipas llojit të procedurës, nga të cilat rezulton që në vitin 2021, 59.9% e kontratave me status PMK ishin zhvilluar me procedurë të hapur, 11.7% me procedurë të negociuar dhe 28.4% të tjera. Në vitin 2022, 61.1% e kontratave me status PMK ishin zhvilluar me procedurë të hapur, 9.3% me procedurë të negociuar dhe 29.7% të tjera. Kurse në vitin 2023, 67.3% e kontratave me status PMK ishin zhvilluar me procedurë të hapur, 7.6% me procedurë të negociuar dhe 25.1% të tjera.

Ndërsa, në grafën poshtë djathtas, janë paraqitur përqindjet e përdorimit të modullit të menaxhimit të kontratës sipas nivelit qendror apo lokal. Në vitin 2021, 54.5% ishte shkalla e përdorimit nga niveli qendror dhe 45.5% nga niveli lokal. Në vitin 2022, 59.4% ishte shkalla e përdorimit nga niveli qendror dhe 40.6% nga niveli lokal. Në vitin 2023, 59.8% ishte shkalla e përdorimit nga niveli qendror dhe 40.2% nga niveli lokal.

Dominimi i kontratave për furnizim në përdorimin e modullit mund të reflektojë natyrën e prokurimit publik në Kosovë ose mund të sugjerojë që këto lloje kontratash janë më të përshtatshme për menaxhim përmes modullit. Rekomandohet një analizë e mëtejshme për të kuptuar nëse ka nevoja specifike për përmirësimin e modullit për të akomoduar më mirë kontratat e shërbimeve dhe punëve.







Kontratat me status vlerësimi

- Përqindja e kontratave me vlerësime të përfunduara është e ulët dhe në rënie (nga 7% në 2021 në 2.7% në 2023), kurse shumica dërmuese e kontratave (87-93%) nuk janë vlerësuar, çka përbën një fushë të rëndësishme për përmirësim.

Në grafën e parë majtas, janë paraqitur numri i kontratave që kanë status vlerësimi do të thotë kanë përdoruar kërkesën për vlerësimin e performancës, kontratat që nuk kanë status vlerësimi dhe ato që janë në proces. Kurse, në grafën e dytë është paraqitur raporti i shprehur në përqindje.





Nga të cilat rezulton që në vitin 2021, 7% e kontratave kanë status vlerësimi, 87.4% nuk janë vlerësuar, kurse 5.6% janë në proces. Në vitin 2022, 5.3% e kontratave kanë status vlerësimi, 88.8% nuk janë vlerësuar, kurse 5.9% janë në proces. Në vitin 2023, 2.7% e kontratave kanë status vlerësimi, 93.2% nuk janë vlerësuar, kurse 4% janë në proces.

Përqindja e ulët e kontratave me status vlerësimi (2.7% në 2023) sugjeron një fushë të rëndësishme për përmirësim. Kjo mund të tregojë mungesë të ndërgjegjësimit për rëndësinë e vlerësimit të performancës, vështirësi në përdorimin e kësaj veçorie të modulit, ose mungesë të udhëzimeve të qarta për procesin e vlerësimit. Rekomandohet një hetim i mëtejshëm për të identifikuar barrierat specifike dhe për të zhvilluar strategji për të rritur përdorimin e kësaj veçorie kritike.







Top Autoritetet me përdorimin më të lartë të PMK

Grafet më lartë tregojnë numrin e kontratave me Plan të Menaxhimit të Kontratës (PMK) për autoritetet kryesore. Vërehet se disa autoritete si KEK, QKUK, SHSKUK, Ministria e Shëndetësisë kanë një numër të lartë të kontratave me PMK. Kjo mund të tregojë një angazhim të fortë të këtyre institucioneve në përdorimin e modulit, por gjithashtu mund të reflektojë volumin e lartë të kontratave që ato menaxhojnë.



Top Autoritetet me përdorimin më të lartë të PMK sipas përqindjes në krahasim me totalin

Në grafet më lartë janë paraqitur përqindja e kontratave me status PMK krahasuar me totalin e kontratave për secilin autoritet. Kjo ofron një perspektivë më të balancuar të adoptimit të modulit. Për shembull, ndërsa një autoritet mund të ketë një numër më të vogël të kontratave me status PMK, përqindja e lartë tregon një adoptim më të plotë të modulit në proceset e tyre. Kjo analizë krahasuese është veçanërisht e dobishme për të identifikuar praktika më të mira që mund të replikohen në autoritete të tjera.



Autoritetet që nuk e kanë përdorur Modulin e Menaxhimit të Kontratës

Kjo figurë identifikon autoritetet që kanë përdorim minimal ose zero të Modulit të Menaxhimit të Kontratave.

Kjo analizë thekson nevojën për një qasje të diferencuar në promovimin dhe mbështetjen e përdorimit të modulit, duke marrë parasysh specifikat e secilit autoritet.

Rekomandime

- Zhvillimi i një programi gjithëpërfshirës trajnimi për të adresuar fushat specifike të identifikuar me përdorim të ulët, veçanërisht vlerësimin e performancës së kontraktuesve.
- Krijimi i një grupi punues për të hetuar arsyet e përdorimit të ulët të modulit në disa autoritete kontraktuese dhe për të zhvilluar strategji të personalizuar për përmirësim.
- Implementimi i një sistemi të strukturuar për mbledhjen e feedback-ut nga përdoruesit për të identifikuar përmirësimet e nevojshme në funksionalitetin e modulit.
- Zhvillimi i udhëzuesve të detajuar dhe materialeve referuese për çdo aspekt të modulit, me fokus të veçantë në proceset më pak të përdorura siç është vlerësimi.
- Konsiderimi i integritetit të modulit me sisteme të tjera relevante të menaxhimit financiar për të rritur efikasitetin dhe adoptimin e tij.

